



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 30.10.2023, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqatës “AREA” për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 27, datë 16.02.2023, “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 08.02.2023”.
2. Mbi shqyrtimin e propozimit të OST sh.a. për miratimin e Rregullores së alokimit në hije të kapaciteteve (Shadow Auction) në kuadër të bashkimit të tregjeve Shqipëri – Kosovë.
3. Mbi pezullimin e vendimarrjes së bordit të ERE-s për rinovimin e licencës së shoqërisë “ECO-ELB” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “SWISS BALANCING POOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “SWISS BALANCING POOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguroese dhe hipotekës) të aseteve në projektin solar të Karavastasë në favor të palës huadhënëse.